



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMI I KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË DETYRUAR PËR
SHKOLLAT E MESME TË GJUHËVE TË HUAJA**

FUSHA: GJUHË E HUAJ

LËNDA: GJERMANISHT

KODI: 3.3.11.Zgj.(f)

**PROGRAMI I LËNDËS
GJERMANISHT
PËR KLASËN E 11-të
NIVELI FILLESTAR**

Koordinatori: Erifili Hashorva

Redaktori: Gazmend Krasniqi

Përgjegjës sektori: Marita Hamza

TIRANË, KORRIK 2010

Programi i gjuhës gjermane – si gjuhë e tretë (me zgjedhje) për klasën e 11-të të Shkollave të Mesme të Gjuhëve të Huaja të nivelit fillestar është një dokument zyrtar. Programi përdoret për nxënësit me nivelin fillestar gjuhësor, duke synuar që të arrihet niveli A1.

Ky program mbështetet në orientimet e Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët dhe mundëson zhvillimin e pavarur të nxënësve, formimin intelektual, e socio-kulturor të tyre.

Ky program ka për synim njohjen dhe formimin gjuhësor të nxënësve, duke i përgatitur për studime të mëtejshme me qëllim që t'i bëjnë ballë tregut të punës, si brenda edhe jashtë vendit.

Programi i gjuhës gjermane për klasën e 11-të (gjuhë me zgjedhje) për nivelin fillestar është konceptuar dhe përpiluar në mënyrë të tillë që me anë të dijeve të përftuara gjatë procesit mësimor nxënësi/ja të zhvillojë personalitetin e tij/saj, duke rritur besimin si përdorues i gjuhës, si dhe rrit ndjenjën e përgjegjësisë ndaj procesit të komunikimit në gjuhën e huaj.

1. SYNIMI I LËNDËS.

Programi i gjuhës gjermane për klasën e 11-të për nivelin fillestar –si gjuhë e tretë-synon: të hedhë bazat gjuhësore, dhe në përfundim të programit nxënësit të arrijnë nivelin A1; të zhvillojë të katër aftësitë gjuhësore (dëgjimin, leximin, të folurin e të shkruarin) dhe bashkëbisedimin bazë gjuhësor e ndërkulturor të nxënësve.

2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Në përfundim të klasës së 11-te nxënësi duhet:

- të ndërgjegjësohen për kulturën e vendeve gjermanishtfolëse;
- të reagojnë ndaj ndryshimit të kulturave të të dyja gjuhëve;
- të përdorin njohuritë gjuhësore e kulturore në kontekste të caktuara kuptimore,
- shkathësi dhe saktësi në komunikimin me shkrim dhe me gojë;
- të ketë aftësi për të lidhur situatat gjuhësore të krijuara në klasë me ato të jetës reale;
- të jetë i aftë për të bërë dallimet ndërmjet kulturave të ndryshme.

Realizimi i këtyre objektivave është detyrim për përdoruesit e programit dhe për të gjithë nxënësit, ç'ka do të thotë se atyre u mundësohet nxënia e njohurive të përshkruara në objektiv.

3. OBJEKTIVA

Objektivat e programit të gjuhës gjermane të klasës së 11-të për nivelin fillestar përcaktohen me hollësi sipas aftësive dhe standardeve të cilat janë:

a) Objektivat sipas standardit në komunikim

Përshkrimi: Nëpërmjet situatave të ndryshme, të përshtatshme për grupmoshën dhe nivelin gjuhësor, këta objektiva i mundësojnë nxënësit të përftojnë njohuri fillestare gjuhësore të nevojshme për të përballuar situata të komunikimit të përditshëm në një mjedis gjuhësor e kulturor gjermanishtfolës.

Kjo linjë pasuron dijet e përgjithshme të nxënësit dhe e përgatit atë emocionalisht për një përballje reale me gjuhën dhe kulturën.

	Objektiva
Kultura dhe Komunikimi	<p>Në përfundim të klasës së 11-të të nivelit fillestar nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të ndjekë biseda të thjeshta; • të hamendësojë; • të kuptojë informacione të thjeshta; • të këmbëjë; • të miratojë; • të kundërshtojë; • të përcjellë një informacion të thjeshtë, të kërkuar ; • të shprehë pëlqimet dhe mospëlqimet; • të krahasojë; • të bëjë dallimin; • të klasifikojë; • të shprehë ndërvarjen e veprimeve, fakteve etj. • të tregojë; • të përsërisë; • të ndërveprojë; • të shkruajë; • të hartojë; • të përshkruajë; • të përmbledhë;
Aktet dhe Funkcionet e Komunikimit	<p>Në përfundim të klasës së 11-të, në situata të jetës së përditshme, si: festa, takime, ditëlindje, treg, shkollë, mbrëmje, ekskursione etj., nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të miratojë; • të kundërshtojë; • të kërkojë dhe japë leje; • të urojë; • të shprehë keqardhje dhe dëshira; • të falë dhe kërkojë falje; • të nxisë;

	<ul style="list-style-type: none"> • të shprehë pëlqime dhe mospëlqime; • të tregojë përvoja të ndryshme;
--	---

b) Objektivat sipas standardit ne formimin gjuhësor

Përshkrimi: Objektivat e standardit ne këtë fushë e aftësojnë nxënës/in,-en të prodhojnë elemente gjuhësore që i përkasin nivelit A1. Strukturat gjuhësore në këtë nivel janë të thjeshta dhe realizohen nëpërmjet situatave të ndryshme ligjërimore, ku nxënës/i, -ja nxitet të praktikojë fjali dhe shprehje të thjeshta të gjuhës gjermane, si dhe nxitet të kuptojë lidhjen dhe përdorimin e saktë të tyre në ligjërimin me gojë dhe me shkrim.

	Objektiva
Struktura gramatikore	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë; • të zgjedhojë; • të shkruajë; • të tregojë thjesht mbi jetën e tij të përditshme; • të riprodhojë tekste të thjeshta; • të ngrejë hipoteza (ich glaube ,...../ ich vermute,.....); • të përdorë foljen në kohën e tashme dhe të shkuar; • Më poshtë trajtohen disa forma dhe struktura gramatikore rekomanduese për këtë nivel; • Emri dhe lakimi i tij; • Përemrave vetor dhe pronor; • Parafjalë të rasës kallëzore , dhanore, dhe Wechselpräpositionen; • Foljet modale; • Präsens und Perfekt; • Präteritum “sein “ “haben”; • Mënyra urdhërore; • Mohimi; • Fjalja dëftore; • Llojet e pyetjeve; • Verben mit Ergänzungen; • Verben ohne Ergänzungen; • Das Vorfeld.

4. OBJEKTIVAT SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

Aftësia	Objektiva
Të folurit	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • T’i japë dhe t’i marrë dikujt diçka nëpërmjet të folurit; • T’i bëjë pyetje bashkëfolësit për vendbanimin e tij, familjen si dhe t’i përgjigjet pyetjeve të bashkëfolësit nëse ai flet ngadalë; • Të zhvillojë dialogë të shkurtër sipas shembujve të dhënë; • Të përdorë nocionin e numrave, sasisë, çmimet, orën, ditët e javës dhe stinët e vitit; • Të flasë në mënyrë të thjeshtë për kohën e lirë dhe interesat e veta; • Të thotë nëse kupton apo jo diçka. • Të kërkojë në mënyrë të thjeshtë t’i përsërisin diçka; • Të përshkruajë thjeshtë vendin ku banon.
Të shkruarit	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet :</p> <ul style="list-style-type: none"> • të plotësojë një pyetësor me të dhëna vetjake, si: emri, mbiemri, adresa, kombësia etj.; • të shkruajë një kartolinë të thjeshtë urimi; • të shkruajë fjali të thjeshta dhe të shkurtra për veten si psh: Ku banon? Çfarë bën? Etj. • të shkruajë duke përdorur struktura gramatikore të thjeshta; • të shkruajë një shënim të thjeshtë për të lënë një takim; • të shpreh preferencat e tij me fjali të thjeshta; • të shkruajë duke përdorur shprehje të gatshme nga tekstet; • të shkruajë shifrat deri në 100, datat, ditët e javës, muajt e vitit, stinët, përshkrua motin me fjalë të thjeshta.

Të dëgjuarit	<p>Në përfundim të klasës së 11-të , nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kuptojë kur dikush i flet ngadalë dhe me pauza të gjata; • të kuptojë drejtime të shprehura thjesht; • të kuptojë pyetje dhe udhëzime të drejtuara me shumë kujdes; • të kuptojë frazat, fjalët dhe shprehjet që lidhen me fushat e interesit të tij të çastit si familja, shkolla etj; • të kuptojë numrat, kohën, ditët e javës, muajt e vitit, stinët dhe çmimet; • të kuptojë një përshkrim të shkurtër të rrjedhës së ditës;
---------------------	--

5. KËRKESA TË GJUHËS GJERMANE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Integrimi ndërëndor është një element i rëndësishëm mbi të cilin mbështetet programi lëndor i gjuhës gjermane për klasën e njëmbëdhjetë. Synimi është aftësimi i nxënësit në përdorimin e njohurive gjuhësore, duke theksuar këtu katër aftësitë bazë: të folurit, të shkruarit, të lexuarit, të dëgjuarit.

Lëndët me të cilat mund të ndërveprojë gjuha gjermane janë:

Gjeografia, e cila me njohuritë e saj mund t'i japë nxënësve informacione për vendet gjermanishtfolëse (Gjermani, Austri, Zvicër), vendet turistike, peisazhin, veprat e artit dhe t'i afrojë ato më tepër me kulturën e këtyre vendeve. Nxënësit do të mësonin për klimën, relievin, lumenjtë të këtyre vendeve etj.

Sociologjia, e cila do të ndihmonte nxënësit të njihnin dhe të kuptonin më mirë zakonet, kulturën, traditën e këtyre vendeve. Nxënësit do të ndërgjegjësoheshin më shumë për diversitetin e kësaj bote dhe do të bëheshin më të ndërgjegjshëm, më tolerant duke kuptuar dhe thelbin e mentalitetit të këtyre vendeve.

Historia, e cila nëpërmjet informacioneve të saj mund t'i afronte nxënësit më tepër me historinë gjermane. Ngjarjet e rëndësishme historike që shënuan fatin e shumë vendeve në botë dhe të vetë Gjermanisë do t'i ndihmonin nxënësit të formonin mendimin e tyre për këto ngjarje duke kultivuar tek ato një mendim kritik.

Edukimin mjedisor: Ndotja dhe mbrojtja e mjedisit janë tema që shoqërohen me fjalor e struktura gjuhësore, të cilat trajtohen jo si një qëllim më vete, por në një kontekst kuptimplotë dhe edukativ.

6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi i gjuhës gjermane për klasën e 11-të është një dokument zyrtar, si pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e gjuhës gjermane dhe duhet të zbatohet nga mësues, autorë të teksteve etj.

Siç është përmendur dhe më lart dokumentet e tjera kryesore janë:

- Kuadri i Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja.
- Kurrikula Kombëtare e Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar.
- Standardet e arritjes.

Programi i klasës 11-të orienton gjithë procesin e mësimdhënies e të nxënies së gjuhës gjermane në nivelin A1.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit, është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Është shumë e rëndësishme njohja dhe përvetësimi i programeve lëndore të lëndës së Gjuhës Gjermane për klasën pasardhëse.

Gjithashtu, përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënimit dhe të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.

A. Objektivat

Në këtë pikë duhet patur parasysh se një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Programi për klasën e njëmbëdhjetë është strukturuar në linja që vijnë njëra pas tjetrës, por nuk do të thotë se mësimdhënia-nxënia duhet të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor.

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënës/it,-et dhe janë detyrim për përdoruesit e programit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë çka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema, kapituj, njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

B. Orët mësimore

Gjuha gjermane si gjuhë me zgjedhje për klasën e 11-të të shkollave të Mesme të Gjuhëve të Huaja për nivelin fillestar zhvillohet me 3 orë mësimore në javë dhe shpërndarja e orëve të planifikuara sipas standardeve që vijnë njëra pas tjetrës.

Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës së gjuhës gjermane, mbasi sasia e orëve rekomandohet sipas standardeve. Por kjo nuk do të thotë se mësimdhënia e nxënia do të zhvillohet në këtë renditje gjatë gjithë vitit shkollor. Ata janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Kjo do të thotë se kur mësues/i, -ja ndeshet me vështirësi të caktuara në përmbushjen e objektivave të kapitullit ai/ajo ngadalëson hapin. Por mund të ecë më shpejt në realizimin e objektivave, kur vë re se nxënësit provojnë me shkrim apo me gojë një përvetësim të kënaqshëm në gjuhën gjermane.

Afërsisht **70%** e orëve mësimore të përgjithshme në programin e gjuhës gjermane për klasën e 11-të për nivelin fillestar përdoret për shtjellimin e njohurive të reja lëndore, dhe **30%** e tyre përdoren për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Shpërndarja e orëve mësimore

Gjuha gjermane për klasën e 11-të për nivelin fillestar – gjuhë me zgjedhje-zhvillohet me 3 orë mësimore në javë (**36 javë x 3 orë = 108 orë vjetore**).

Gjatë shtjellimit linear të lëndës në tekst (në kapituj e njësi mësimore) linjat dhe nënlinjat ndërthuren me njëra-tjetrën. Mësuesi është i lirë të bëjë kombinimin e tyre brenda një kapitulli ose një njësie mësimore, pavarësisht renditjes së shpërndarjes së orëve për sa vijon:

Komunikimi dhe formimi kulturor zë 76 orë, të cilat ndahen sipas nënlinjave që i përgjigjen 53 orë mësimore për *Kulturën dhe komunikimin* (nga të cilat 70% e tyre që përbëjnë 32 orë do të jenë për trajtimin e lëndës së re, ndërsa 30% e tyre që përbëjnë 21 orë do të shërbejnë për përpunimin e njohurive: me përpunim do të kuptojmë p.sh., përforcimin e informacionit të marrë në temat përkatëse apo ushtrime për mendimin kritik rreth këtij informacioni) dhe 23orë për *Aktet dhe funksionet e komunikimit* (nga të cilat 70% e tyre që përbëjnë 15 orë mësimore që shërbejnë për njohuritë e reja, ndërsa 30% e tyre d.m.th. 7 orë mësimore do të përdoren për përpunimin e njohurive.)

Në këtë linjë mësuesi bën përpunim njohurish për integrimin tërësor të lëndës d.m.th. ai jep detyra komplekse ku pasqyrohen njohuritë e përfuara sipas linjave dhe nënlinjave në një kapitull.

Formimi gjuhësor zë 32 orë. Janë kryesisht orë në të cilat mësuesi shtjellon në bashkëveprim me nxënësit njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore gramatikore e leksikore (nga të cilat 70% e tyre që përbëjnë 22 orë mësimore për trajtimin e strukturave të reja, ndërsa 30% e tyre që përbëjnë 10 orë do të shërbejnë për rimarjen, përpunimin dhe përforcimin e tyre).

Realizimi i orëve të përgjithshme (72 orë në vit) është sa i detyrueshëm aq edhe elastik. Është i detyrueshëm sepse duhen zhvilluar të gjitha orët e planifikuara deri në fund të vitit shkollor, është elastik sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është kompetencë e mësuesit të gjuhës gjermane P.sh. 10% e orëve sipas linjave dhe nënlinjave mësuesit janë të lirë t'i përdorin si brenda një linje për shtesë, ashtu edhe të transferojnë një linjë tjetër në varësi të nevojave të nxënësve.

Përmbajtja mësimore e lëndës së gjuhës gjermane për klasën e 11-të për nivelin fillestar si gjuhë e dytë realizohet përmes linjave dhe nënlinjave që fillon nga nivelin A1.

Strategjitë e të nxënit

Më poshtë disa strategji dhe teknika të ndryshme, sipas 4 aftësive gjuhësore: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit.

Aftësia	Strategjitë
Të dëgjuarit	<p>Në përfundim të klasës së 11-të , nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojë dhe të përqendrohet në kërkesat e dëgjimit; • Të kuptojë dhe klasifikojë pikat kyçe të tekstit; • Të dëgjojë një tekst të shkurtër dhe të kuptojë, fjalë, fraza dhe fjali të thjeshta; • Të përqendrohet në kërkesat e dëgjimit; • Të nxjerrin përfundime, të dallojnë reagime dhe emocione në tekstin e dëgjimit.
Të folurit	<p>Në përfundim të klasës së 11-të , nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të japë përgjigje të shkurtra, të thjeshta për atë që shohin dhe dëgjojnë; • Të përdorin shprehje të ngulitura për qëllime të caktuara si kërkimi i ndihmës dhe lejes. • Të përdorë shprehje si: Mm. Ja, Aber, Gut usw; • Të pyesë kur nuk kupton diçka.
Të shkruarit	<p>Në përfundim të klasës së 11-të , nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kopjojë me saktësi fjalë e fjali të njohura të veçanta; • Të shkruajë fjali të thjeshta për të hartuar tekste të shkurtra të jetës së përditshme; • Të redaktojë dhe të rihartojë punimin e tij.
Të lexuarit	<p>Në përfundim të klasës së 11-të , nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përdorë libra e fjalorë për të gjetur kuptimin e fjalëve të reja. • Të arrijë të kuptojë fjalë, togfjalësha të shkurtër të

	<p>paraqitur në një kontekst të njohur;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kërkojë të dhëna që e ndihmojnë për të parashikuar përmbajtjen e tekstit si: figura, titulli i mësimit etj. • Të arrijë të kuptojë tekste të shkurtra kur lexon për interes apo informacion vetjak duke shfrytëzuar një larmi burimesh informuese të thjeshta.
--	--

Parime për zbatimin e programit

Më poshtë disa parime për zbatimin e programit :

Vendosja e nxënës/it,-es në qendër të vëmendjes

Nxënësi duhet të jetë në qendër të procesit mësimor dhe të gëzojë të drejta të plota pjesëmarrjeje duke shprehur përvojën e tij jetësore. Kjo do të realizohet:

- Duke përzgjedhur tema, lloje të teksteve dhe forma sociale të orientuara sipas interesave dhe nevojave të moshës së klasës së 11-te, duke patur parasysh nivelin dhe rezultatet e tyre.
- Duke përdorur strategji që e nxisin nxënës/in,-en të veprojnë me gjuhën.
- Duke e përfshirë nxënësin në vlerësimin dhe vetëvlerësimin e dijeve të përftuara.

Organizimi i klasës

Duke dalë nga forma standarde, tashmë e vjetruar e mësimdhënies frontale dhe duke e vënë nxënësin në qendër të vëmendjes mësuesi do të bëhet organizues, furnizues dhe orientues për nxënësit duke i bërë ata pjesë aktive dhe jo pasive në mësim. Ai do t'i ndihmojë nxënësit për një të mësuar të qëndrueshëm. Mësuesi ka më tepër rol planifikues sesa burim i të gjitha njohurive në klasë.

Mësimdhënia ka në qendër të saj metodën komunikative, metoda me bazë detyrën, metoda funksionale dhe ajo e situatave sa më afër jetës reale etj.

Mësuesi është i lirë dhe i pavarur në përdorimin e metodave dhe materialeve mësimore që mbështesin krijimtarinë dhe pavarësinë mendore si të nxënësve, ashtu edhe të mësuesve.

Puna në grupe, me partner motivon nxënësit të cilët mësojnë më tepër nga shkëmbimi i informacionit me njeri-tjetrin. Mësuesi ideon orën e mësimit dhe nxënësit bëhen aktive nëpërmjet formave bashkëvepruese të mësimdhënies të cilat zgjidhen nga mësuesi. Në nivelin A1 duhet të punohet që nxënësi/i,-ja të punojë në mënyrë të pavarur, duke menduar vetë për zgjidhjen e një problemi.

Të mësuarit bashkëveprues

Format e reja të punës p.sh. në grupe, me partner i bën nxënësit më bashkëveprues, më tolerant duke i aftësuar të përdorin forma demokratike në bashkëbisedim duke ndarë përgjegjësitë dhe punën. nxënësit mësojnë të shoqërohen dhe të punojnë me të tjerë.

Nxënësit aftësohen drejt pavarësisë në rritje në përfitimin gjuhësor gjatë mësimit të gjermanishtes, e mundësuar kjo nëpërmjet aktiviteteve përkatëse të të mësuarit, formave të larmishme sociale.

Të mësuarin e gramatikës

Gjuha gjermane ka si element të rëndësishëm dhe strukturat gramatikore të cilat nuk duhet të jepen të izoluara, si qëllim në vetvete, por në lidhje me aftësitë gjuhësore dhe me përpunimin e temave dhe kompetencave leksikore.

Gramatika duhet të konceptohet përgjithësisht në mënyrë deduktive me qëllim që të nxiten nxënësit drejt një procesi analitik dhe nga mendimi kritik. Kjo do të thotë që nxënësi duhet të dalë vetë nëpërmjet shembujve të shumtë dhe të larmishëm tek rregulli gramatikor. Duhet të hiqet dorë nga dhënia e rregullave dhe tabelave shabllone, paraprake nga mësuesit.

Puna e diferencuar

Më qëllim që metodat e mësimdhënies/nxënies, parimet dhe strategjitë mbi të cilat realizohen këto metoda të kenë arritje sipas standardeve të përcaktuara, mësuesi planifikon punën e diferencuar me nxënësit.

Duke patur parasysh përbërjen heterogjene të klasave tona mësuesi duhet të parapëlqejë punën në grupe, kështu ai mund të krijojë grupe të ndryshme me nxënës/e të përparuar dhe të prapambetur duke caktuar detyra në grup për të mos i vënë në vështirësi këta nxënës dhe për t'i inkurajuar të zgjidhin ato detyra që munden. Mësuesi mund t'u japë gradualisht detyra plus për të siguruar një nivelim të tyre me të tjerët, por duke bërë kujdes që të mos rrisë vështirësitë e tyre dhe duke gjetur detyra motivuese e tërheqëse.

Një motivim i mirë për thellimin e njohurive të gjermanishtes, konkretisht për nxënësit e përparuar është puna e veprimtarive shtesë, si përzgjedhje e materialeve autentike, krijime me shkrim në kuadër konkurses, recitime ose vënie në skenë të pjesëve të ndryshme në gjuhë të huaj, etj. Ai mund të përdorë punën e këtyre nxënësve për të realizuar bashkë me ta një aspekt shumë të rëndësishëm të metodologjisë së zbatimit të programit si integrimi lëndor, ku nxënësit e përparuar mund të sjellin një kontribut të konsiderueshëm nëpërmjet transferimit të njohurive të tyre nga gjuha dhe kultura amtare në gjuhën dhe kulturën e huaj dhe anasjelltas.

Si rekomandim më poshtë ka disa teknika për tërheqjen e të gjithë nxënësve në procesin mësimor:

- të ketë vullnetin dhe dëshirën për t'i dëgjuar dhe për t'u dhënë përgjigje nxënësve;
- të ndjekë klasën në çdo hap, brenda dhe jashtë saj;
- të ndajë përgjegjësitë atje dhe atëherë kur duhet, për çështje vendimi, detyra shtëpie apo klase, detyra me shkrim etj;
- të japë vazhdimisht përshkrime të punës së nxënësve;
- të kërkojë prej tyre vlerësime të punës së tij, me qëllim që të reflektojë ndaj dobësive;
- të shmangë çdo gjë që nuk i përshtatet moshës së nxënësve;
- të zgjedhë materiale për mësim në përputhje me kërkesat dhe standardet e programit mësimor;

- nëse diçka nuk ecën në klasë, përpiqet ta mënjanojë dhe të përdorë punën në grup ose për individë të veçantë, punën individuale;
- të përdorë ushtrime që kërkojnë pjesëmarrje aktive, duke nxitur edhe nxënësit me dije jo të plota të përfshihen në to;
- të shmang ushtrime që i vënë këta nxënës në vështirësi dhe i zënë ngushtë;
- të motivojë nxënësin edhe për një detyrë fare të vogël që ka bërë, me qëllim që të rritet dëshira dhe përgjegjësia për mësimin e gjuhës së huaj;
- të mos paragjykoj nxënësit, por përkundrazi tu jap ushtrime që kërkojnë vëmendje dhe punë.

7. VLERËSIMI

Matja e përparimit dhe arritjeve të nxënësve në gjuhën e huaj, duhet të jetë objektiv dhe i matshëm dhe do të realizohet nga vlerësimi i përparimit të nxënësve. Të vlerësosh nxënësin nuk është e lehtë dhe kjo mund të bëhet në mënyra nga më të ndryshme.

Vlerësim diagnostikues

Duke njohur dhe vlerësuar arritjet dhe mangësitë, duke i dëgjuar nxënësit të flasin dhe lexojnë, duke vëzhguar të shkruarit e tyre dhe duke analizuar aftësitë dhe gabimet e nxënësve përmes përdorimit të analizës së rezultateve dhe evidencave të rregullta mësuesi do të mund të realizojë këtë vlerësim:

- ky lloj vlerësimi jep informacion për efektshmërinë e të nxënit;
- ndihmon në gjetjen e mënyrës së veprimit në etapën e dytë të të mësuarit;
- ndihmon të gjenden arsyet dhe shkaqet e mospërvetësimit të koncepteve.

Vlerësim formues

Nëpërmjet këtij vlerësimi synohet të theksohet ajo çfarë ka arritur nxënësi gjatë procesit të formimit të njohurive. Ky vlerësim kryhet në fillim: për vendosjen e objektivave në procesin mësimor, gjatë vitit, për të vlerësuar ecurinë e njohurive të fituara, për përmirësim si dhe në fund të vitit për të parë se çfarë është arritur.

Më poshtë sugjerohen disa veprimtari ose kërkesa për vetëvlerësimin formues:

- pas një veprimtarie të bëhet një pushim dhe të bëhet pyetja “Çfarë keni mësuar?”;
- t’i bëhet e ditur nxënësit që gjithnjë duhet të bëjë një bilanc të gjërave të mësuarra dhe atyre të përvetësuarra;
- në një situatë me rezultat të lartë të pyeten nxënësit “Çfarë bëtë për të arritur këtë rezultat?” dhe të nxiten ata të shkëmbejnë përvojën e tyre mbi këtë temë;
- pas një krijimi me shkrim, t’i kërkohet nxënësit të tregojë çdo gjë për të cilën është i sigurt në tekstin e tij (p.sh. duke nënvizuar)

Vlerësim përmbledhës

Ky vlerësim bëhet në fund të një numri temash, njësisish, detyrash e kapitujsh , ose në fund të një periudhe të caktuar kohore.

Vlerësim motivues: ka për qëllim të nxit interesin dhe dëshirën e nxënësve për të mësuar.

Vlerësimi i nxënës/it,-es përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënës/it,-es nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi i nxënës/it,-es duhet të jetë sa më objektiv dhe i matshëm.

Do të inkurajohen nxënësit të njohin procedurat e vlerësimit si mundësi për *vetëvlerësim*. Nxënësit do të nxiten të zhvillojnë të menduarit e pavarur dhe vetëdijen për aftësinë e tyre për përmirësimë përmes kuptimit të hollësishëm të proceseve të vlerësimit. Nxënësit vlerësojnë veten nëpërmjet një pyetësi mbi atë ‘‘se çfarë di të bëjë?’’.

Vetëvlerësimi është një formë e re por mjaft e përhapur tashmë në botën arsimore. Ai është pjesë e të mësuarit të pavarur dhe konsiderohet mjaft i nevojshëm si nga nxënësit ashtu dhe nga mësuesit. është detyrë e çdo mësuesi të shpjegojë dhe të njohë nxënësit me përmbajtjen e vetëvlerësimit, përdorimi i të cilës do të sjellë ndërgjegjësime të mëtejshme të problemeve të të mësuarit.

Si mjet në vlerësim dhe vetëvlerësim shërben Portofoli Evropian Gjuhëve(PEGJ), që me anë të tri pjesëve të tij Pasaportës Gjuhësore, Bibliografisë gjuhësore dhe Dosjes, nxisin nxënësin të mendojë mbi nivelin e tij gjuhësor, duke vetëvlerësuar njohuritë e marra, dhe dokumentimin e arritjeve të tij gjuhësore që mund të jenë provime me shkrim, detyra tematike, certifikata, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive aurikulare.

PEGJ është dokumenti në të cilin çdo nxënës që mëson ose ka mësuar një gjuhë që mësohet në shkollë ose jashtë saj, mund të shënojë njohuritë e tij gjuhësore dhe përvojat kulturore. PEGJ e nxit nxënësin të mësojë më shumë gjuhë, edhe në nivele modeste dhe të vazhdojë t’i mësojë gjuhët përgjatë gjithë jetës. PEGJ e nxit nxënësin të përmirësojë mësimin dhe aftësinë e vlerësimit të aftësive të tij në fushën e gjuhëve. PEGJ kontribuon në mirëkuptimin reciprok në Evropë nëpërmjet njohjes së drejtpërdrejtë të kulturave të tjera dhe ndihmës së kapaciteteve të komunikimit në shumë gjuhë.

- Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte. Më pas mësuesi dhe nxënësit bëjnë komentimin përfundimtar.
- Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe, duke marrë role të ndryshme, madje dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit.
- Mësuesi bisedon me nxënësin individualisht dhe i tregon arritjet.

Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin që ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi: ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu të organizojnë më mirë të nxënit e tyre. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi.

Gjithashtu mund t’i kërkohet nxënësit të hartojë një skedë vetë-korrigjimi, për të korrigjuar me shkrim gabimet më të shpeshta ose ta integrojë korrigjimin në veprimtarinë e kërkuar.

Bashkëbisedimi i lirshëm dhe i hapur me mësuesin është elementi më i rëndësishëm dhe nuk është detyrim për mësuesin vënia e notave çdo orë mësimore, ai duhet të vendos herë pas here nota, por këto nuk duhet të jenë objektivi i vetëm i punës gjatë orës së tij mësimore.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin në komunikimin me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike. Mësuesi vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të realizuara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një ose disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga testet e vogla pakminutëshe për një objektiv të veçuar të të nxënit, deri tek ato njëorëshe, teste me alternativë ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurikulare etj.

Një formë e punës me shkrim nga nxënësit është dhe *provimi përfundimtar*. Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, kurse mësuesi është në rolin e atij që drejton dhe që rekomandon.